



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI - OPSTINA VUCITRN



Drejtoria Komunale për Prokurim Publik
VU644-25-6988-5-2-1/C1115
14 Nr. 1046/25
Dt. 24.09.2025

KONTRATË PUNE

Palët kontraktuese :

1. Komuna e Vushtrrisë, si autoritet kontraktues, të cilën e përfaqëson **z. Ilmi Azemi** - Drejtor i Drejtorisë Komunale për Prokurim Publik (në tekstin e mëtejme **PORORSITËSI**), dhe
2. **Grupi i O.E. : “ Froni 1 “sh.p.k. emri i biznesit, me ARBK: 810155524, me seli në Prishtinë & “ Ideal Partners “sh.p.k. emri i biznesit/ “ Ideal Partners “emri tregtar, me ARBK : 811913997, me seli në Drenas (Glllogoc) & “ ProBuild Group ”sh.p.k. emri i biznesit, me ARBK: 812301753, me seli në Prishtinë, të cilët i përfaqëson **z. Alban Podrimqaku**, në tekstin e mëtejme: **KRYESI I PUNËVE**, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për pune e shënuara me poshtë: **Rrethoja e çelikut – Ura e madhe e Silnicës – Komuna Vushtrri**, me numër identifikues:**

Nr. i Prokurimit	VU644	2	5	69	8	8	5	2	1
Nr. i brendshëm	VU644	2	5	0	4	8	5	2	1

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i punëve nga ana e Kontraktuesit dhe ka të bëjë me sa vijon : **Ka të bëjë me Rrethoja e Çelikut- ura e madhe e Silnicës - Komuna e Vushtrrisë dhe ndërtimi i shetitorës të shtegut për biçikleta në Vushtrri.**, sipas dokumentacionit standard dhe Specifikimit Teknik të ofertës me : **Nr. i prokurimit : VU644-25 – 6988-521 / Nr. i Brendshëm : VU644-25-048-521**
- **Afati i fillimit të punimeve është 4 (katër) ditë pas nënshkrimit të kontratës, në rast se kushtet klimatike vlerësohen të përshtatshme për punë.**
- 1.2 Afati i përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë : sipas afatit të përcaktuar në Kushtet e Veçanta të Kontratës, jo më gjatë se **30 Nëntor 2026** nga data e fillimit të punimeve.(**projekt dy vjeçar 2025 – 2026**)
- 1.3 Kryesi i punimeve ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Porositësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.
- 1.4 Punëdhënësi, menjëherë pas lidhjes së kësaj kontrate, do të emëroi Menaxherin e Kontratës - Projektit si dhe Mbikëqyrësin e Drejtpërdrejtë të Menaxherit të Kontratës duke i përcaktuar edhe përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me realizimin e kësaj Kontrate dhe ekzekutimin e punimeve sipas projektit.
- 1.5 Punëmarrësi obligohet që, në kërkesë me shkrim të Punëdhënësit apo organit të autorizuar prej tij, të kryej edhe punë tjera shtesë të paparapara lidhur me projektin në fjalë, por që nuk do të filloi me punimet shtesë përderisa me Punëdhënësin nuk arrihet marrëveshje- aneks kontratë me shkrim për të specifikuar punët dhe çmimin.
- 1.6 Vetëm Autoriteti Kontraktues mundë ti miratoi ndryshimet, modifikimet, shmangiet dhe zëvendësimet në Përshkrimin e Punës, në pajtim me dispozitat ligjore në fuqi që rregullojnë këto çështje.
- 1.7 Punëmarrësi ka të drejtë në shtyrje të afatit të kryerjes së punimeve në rast të ndikimit të fuqisë madhore, vonesës së Punëdhënësit në përmbushjen e obligimeve kontraktuese dhe atë për aq ditë sa kanë zgjatur rrethanat që e kanë shkaktuar vonesën.

- 1.8 Punëmarrësi do të penalizohet me shumën prej 0,10% të vlerës së kontratës për çdo ditë vonesë të pajustificuar të kryerjes së punëve të papërfunduara, por që ky dënim, në asnjë mënyrë, të mos mundë të tejkaloi shumën prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontraktuar.
- 1.9 Punëmarrësi, pas përfundimit të procedurave të pranimit teknik të punimeve, përmes afatit garantues i cili nuk mundë të jetë më i shkurtë se 2 (dy) vite , e siguron Punëdhënësin se punët dhe detyrat e besuara janë kryer me një cilësi të lartë dhe sipas konditave të përcaktuara me projekt dhe sipas dispozitave të LMD-së që rregullojnë këtë çështje.
- 1.10 Garantimi i cilësisë së punëve nga ana e Punëmarrësit do të bëhet në afatin dhe në institucionin e përcaktuar si në Kushtet e Veçanta të Kontratës, pjesë e dosjes së tenderit.
- 1.11 Afati garantues fillon nga dita e pranimit teknik të përkohshëm të objektit.
- 1.12 Punëmarrësi obligohet që, brenda afatit kohorë garantues, me ftesë- kërkesë të Punëdhënësit t'i eliminoi, me shpenzime të tija, gjitha të metat eventuale të shfaqura në objekt me fajin e tij dhe atë në afatin prej 5 ditësh pune nga dita e dërgimit të ftesës.
- 1.13 Në rast se Punëmarrësi në afatin e paraparë nuk i ndërmerr veprimet për eliminimin e të metave, Punëdhënësi të metat e paraqitura do ti eliminoi përmes angazhimit të një punë kryesi tjetër, e në barrë të Punëmarrësit, duke shfrytëzuar mjetet financiare të depozituara me Garancion të Sigurimit të Cilësisë.
- 1.14 Punëmarrësi nuk do të përgjigjet për të metat e shfaqura si pasojë e shfrytëzimit – përdorimit jo adekuat të objektit të pranuar. Me këtë rast për bazë do të mirën dispozitat e LMD-së që rregullojnë këtë çështje.
- 1.15 Gjatë kryerjes së punimeve do të udhëhiqet libri ndërtimorë dhe ditari i punës sipas normave ligjore në fuqi, ndërsa Punëdhënësi apo organi i autorizuar prej tij do të vërtetoj punimet e kryera sipas dinamikës, konformë specifikimit në para masë , para llogari dhe planin dinamik të punëve.

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve duhet të jetë: 345,500.00€ (treqindedyzetepesmijëpesqind/00Euro).

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

2.3 Ashtu sikurse është rregulluar edhe me dispozita të Kushteve të Veçanta të Kontratës pjesë e dosjes së tenderit, duke qenë se projekti si në nenin një të kësaj kontrate është projekt afatgjatë (dyvjeçar) ndërkaq, realizimi në tërësi i projektit nxitë ngritjen e obligimeve financiare të Autoritetit Kontraktues – Punëdhënësit – Komunës së Vushtrrisë dhe Ministrisë së Zhvillimit Rajonal më tej (MZHR-së) që duhen përmbushur nga përvetësimet e viteve fiskale 2025 dhe 2026, bazuar dhe në Planifikimin buxhetor të Komunës së Vushtrrisë dhe të Ministrisë së Zhvillimit Rajonal për vitet në vijim, palët kontraktuese pajtohen që dinamika e realizimit të punëve në projektin në fjalë të realizohet në harmoni me dinamikën e përvetësimeve të mjeteve financiare sipas viteve, në pajtim me pjesën e lëndës së kontratës – pjesë e dosjes së tenderit me Nr. prokurimi : VU644-25 – 6988-521 / Nr. i Brendshëm : VU644-25-048-521 , respektivisht dinamika e realizimit të projektit , sipas viteve, 2025 dhe 2026 do të realizohet sipas shumave dhe afateve, me sa vijon :

- në vitin 2025 nga buxheti i A.K. do të sigurohen (zotohen) mjete financiare në shumë prej : 50,000.00€ duke mos përjashtuar mundësinë që AK. të siguroi edhe mjete tjera nga fondi për bashkëfinancim të projekteve dhe / ose mjete nga mjetet e redestinuara nga mbetjet e projekteve të realizuara, ndërsa

-, në vitin kalendarik 2026 , nga buxheti i A.K. , do të sigurohen (zotohen) mjete financiare në shumë prej : 145,500.00€

Ndërsa,

- nga Ministria e Zhvillimit Rajonal, në pajtim me Marrëveshjen e Mirëkuptimit për financimin e projektit “ Rrethoja e Çelikut – Ura e madhe e Silnicës – Komuna Vushtrri “ nr. 574/25 dt. 24.06.2025 (nr. i protokollit të ministrisë / dhe ose nr. 28560/25 dt. 24.06.2025 (nr i protokollit të Komunës s Vushtrrisë) do të sigurohen mjetet financiare , sipas viteve dhe në shumën, me sa vijon :

- në vitin kalendarik 2025 do të sigurohen (zotohen) mjete financiare në shumë prej : 100,000.00€ , ndërsa

- në vitin kalendarik 2026 do të sigurohen (zotohen) mjete financiare në shumë prej : 50,000.00€

2.4 Pagesat financiare për punët e përfunduara dhe të pranuar nga Menaxheri (mbikëqyrësi) i Kontratës - projektit dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës - Projektit në fjalë do të bëhen : në pajtim me Situacionet e aprovuara nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues.

2.5 Në pajtim me nenin 3 paragrafi 2 të Marrëveshjes së cituar si në nenin 2 paragrafi 2.3 të kësaj Kontrate, pagesat për punët e realizuara sipas Kontratës për projektin në fjalë do të bëhen gjithsesi , deri në shpenzimin e mjeteve të zotuar të buxhetit të MZHR-së pagesat kryhen nga këto mjete, e tek pastaj fillojnë pagesat e bashkëfinancimit nga Komuna e Vushtrisë.

2.7 Pagesa e fundit do të kryhet bazuar në Raportin për pranimin teknik të përkohshëm të punimeve të përfunduara, me Situacion të nënshkruar nga Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejt i Menaxherit të Kontratës i Autoritetit Kontraktues, në pajtim me kompetenca dhe përgjegjësitë e tija, sikurse parashihet në nenin 70.23 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik (versioni i konsoliduar) dhe në Vendimin mbi emërimin në detyrë.

Neni 3 Pranimi teknik i objektit

3.1 Pas përfundimit të punimeve Punëmarrësi do të kërkojë pranimin teknik të përkohshëm të objektit të përfunduar, ndërsa Punëdhënësi do të zbatojë procedurat e pranimi teknik të përkohshëm të objektit dhe atë nga momenti kur Menaxheri i Kontratës dhe Mbikëqyrësi Drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës i Punëdhënësit e njoftojnë, me shkrim, Punëdhënësin – Zyrtarin Kryesor Administrativ dhe Departamentin e Prokurimit – Zyrtarin Përgjegjës për Prokurim Publik mbi përfundimin e gjitha punëve të parapara.

3.2 Në pajtim me Kërkesat e saktësuara si ë Kushtet e Veçanta të Kontratës, Punëmarrësi do të depozitojë Sigurimin e Kualitetit të Punëve në shumë prej 10 % të vlerës së përgjithshme të kontratës, për një periudhë garantuese të defekteve prej 2 (dy) viteve nga data e pranimi teknik të përkohshëm në emër të shumës së mbajtje së parash.

Neni 4 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Marrëveshja e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
- (f) Plani për menaxhimin e kontratës;
- (g) Procesverbali i mbledhjes së informatave/vizitës së vendit
- (h) Dhe dokumente tjera të cilat vlerësohen të nevojshme të jenë pjesë e kësaj kontrate.

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

4.3 Në rast të paqartësisë apo mospërputhshmërisë lidhur me dispozitat e kësaj kontrate, palët do të marrin për bazë dispozitat e përcaktuara si në Kushtet e Përgjithshme dhe / ose të Veçanta të kontratës si dhe dokumentacionin pjesë përbërëse e dosjes së tenderit me nr. prokurimi : VU644 – 25 – 6988 – 5-2-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 25 – 048 - 521

4.4 Kontestet eventuale lidhur me dispozitat e kësaj kontrate palët do t'i zgjedhin me marrëveshje, në të kundërtën, kompetent për zgjidhje të kontestit do të jetë Gjykata Komeriale në Prishtinë (Departamenti për Çështje Ekonomike), ndërsa për bazë do të merren dispozitat e përcaktuara si në dokumentacionin – Dosjen e Tenderit me nr. prokurimi : VU644 – 25 – 6988 – 5-2-1 dhe Nr. të brendshëm të prok. VU644 – 25 – 048 - 521

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues



mund të adresohen Autoritetit Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.




5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe¹ në katër origjinale, tri prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për : Autoritetin Kontraktues – Komuna
Vushtrri

Për G.O.E. : “ Froni 1 “sh.p.k. & “ Ideal Partners
“sh.p.k. & “ ProBuild Group”sh.p.k. – Prishtinë

Emri:	Ilmi Azemi	Emri:	Alban Podrimqaku
Pozita:	Drejtor	Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	24.09.2025	Data:	24.09.2025
Vula:		Vula:	

¹ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.